Deklarata rajonale për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe përgjigjja ndaj pandemisë së sëmundjes COVID-19

Kjo deklaratë përcakton objektivat dhe parimet e bashkëpunimit midis sindikatave xx dhe organizatave të shoqërisë civile që shërbejnë për të përmirësuar nivelin e të drejtave të punës në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe për të mbrojtur punëtorët dhe grupet e ndjeshme të qytetarëve nga efektet e krizës ekonomike të shkaktuara nga pandemia e sëmundjes COVID-19.

Nga qeveritë e vendeve tona do të kërkojmë ruajtjen e të drejtave kolektive, respektimin e rregulloreve nga ana e punëdhënësve dhe do të insistojmë në dialog multisektorial dhe social.

Përmes veprimit solidar dhe mbështetjes së ndërsjellë do t'i forcojmë organizatat tona në luftën për klasën punëtore në Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni të Veriut dhe Serbi.

Hyrje

Organizata Ndërkombëtare e Punës vlerëson se mbyllja e plotë ose graduale e ndërmarrjeve dhe kompanive për shkak të pandemisë së sëmundjes COVID-19 prek 81 përqind të fuqisë punëtore botërore, gjegjësisht 2,7 miliardë punonjës. 37,5% e personave kanë qenë të punësuar në sektorë të cilët janë përcaktuar si vende punë me rrezik të lartë nga infeksioni siç janë shëndetësia, sektori shërbyes, prodhimtaria dhe administrata. Humbja e vendeve të punës është e konsiderueshme, si dhe përkeqësimi i pozitës tashmë të pafavorshme të punonjësve me punësim të pasigurt.

Gjithashtu i referohemi premtimit të kohëve të fundit të Bashkimit Evropian për ndihmën që do t'i japë Ballkanit Perëndimor për rimëkëmbjen nga pasojat e pandemisë, të shprehur në kuadër të Deklaratës së Zagrebit[1], ku vihet theks në zhvillimin shoqëror. Po ashtu kemi parasysh edhe Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale[2], sipas së cilës të gjithë anëtarët e BE-së, si dhe vendet që aspirojnë të bëhen pjesë e saj, duhet të mbrojnë punëtorët e tyre nga format e punësimeve të pasigurta dhe t'iu garantojnë pagat që mundësojnë një standard të dinjitetshëm jetese.

Sipas të dhënave që kanë sindikatat në vendet e Ballkanit Perëndimor, gjatë gjendjes së jashtëzakonshme të shpallur nga qeveritë e rajonit, shumë punonjës në industri dhe sektorin privat (sektorin real) vazhduan të punojnë në objektet e prodhimit. Atyre nuk iu siguruan masa adekuate të mbrojtjes së sigurisë dhe shëndetit në punë, dhe punëdhënësit, në shumicën e rasteve, as që zbatuan masat e përcaktuara të mbrojtjes. Presioni më i madh ka qenë mbi punonjësit shëndetësor të cilët shpesh punonin drejtpërdrejt me të infektuarit pa pajisje mbrojtëse, pa trajnim dhe pa protokoll.

Pajtohemi me fjalët e Kombeve të Bashkuara se "ndërsa maskat mbrojtëse mund të jenë për një përdorim, punëtorët nuk mund të jenë"[3].

Fatkeqësisht, moskuptimi dhe moskujdesi i pushtetit dhe punëdhënësve për punëtorët, kompanitë e të cilëve janë të ndaluara të punojnë me qëllim të luftimit të infeksionit me koronavirus, por edhe për ata

[1] https://www.consilium.europa.eu/media/43789/zagreb-declaration-bs-06052020.pdf
[2] https://ec.europa.eu/commission/priorities/deeper-and-fairer-economic-and-monetary-union/european-pillar-social-rights_en
[3] COVID-19: State and business respect for human rights critical to resilience and recovery, say UN experts, https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=25836&LangID=E

kompanitë e të cilëve është dashur të punojnë gjatë gjithë kohës për të siguruar furnizimin me gjëra ushqimore themelore dhe shërbime për qytetarët, do të mbahet mend në histori si një nga karakteristikat thelbësore të tregut të punës në vendet e Ballkanit Perëndimor në kohën e pandemisë.

Baza dhe parimet e bashkëpunimit

Përmes veprimeve të përbashkëta publike dhe bilaterale do të insistojmë në parakushtet e mëposhtme për të bërë realitet punën e dinjitetshme gjatë dhe pas krizës COVID-19:

- Të gjitha qeveritë e vendeve në rajonin e Ballkanit Perëndimor të nisin një dialog konstruktiv me sindikatat gjatë miratimit të masave ekonomike dhe në këtë dialog të jenë veçanërisht të përfshira sindikatat nga sektorët më të prekura nga pandemia
- Përmes reformave me përgjegjësi sociale, si vënia e tatimeve më të drejta dhe tërheqja e investitorëve me përgjegjësi shoqërore, të parandalohen "cunami" të varfërisë, shpërthime të pabarazive socio-ekonomike dhe konflikte brenda shoqërive
- Në asnjë mënyrë nuk guxon të lejohet pakësimi i të drejtave të punës, por, përkundrazi, të avancohen rregulloret në përputhje me standardet më të larta të Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe Bashkimit Evropian
- Të sigurohen masa adekuate të mbrojtjes së sigurisë dhe shëndetit për të gjithë punëtorët

Vargu i masave të propozuara sipas vendeve

Parashihet që Ballkani Perëndimor, si dhe Evropa dhe pjesa tjetër e botës, do të shënojnë një recesion në vitin 2020, shtrirja e së cilit do të varet nga kohëzgjatja e pandemisë COVID-19. Marrëdhënia e ardhshme e nënshkruesve të kësaj deklarate bazohet në parimin e unitetit, por edhe në respektimin e autonomisë dhe prioriteteve specifike në vende të ndryshme. Sipas vendeve janë propozuar një varg masash për veprim të përbashkët.

Për Bosnjën dhe Hercegovinën prioritet janë:

- Pamundësimi i hendekut të mëtejshëm mes niveleve të të drejtave të punëtorëve në entitetet e BH
- Parandalimi i keqpërdorimit të Ligjit të Punës të RS dhe FBH në praktikë përmes shkëputjeve me marrëveshje të kontratave të punës, kërkesave për pushim të papaguar dhe të tjera
- Në masat e ardhshme për stabilizimin e ekonomisë dhe zvogëlimin e pasojave ekonomike të shkaktuara nga pandemia, të sigurohet vazhdimësia e shpenzimeve përmes stimujve financiarë, rritjes së pagës minimale dhe mbajtjes së pagave në nivelin që kishin më 5 mars por edhe masa të tjera që synojnë ruajtjen e nivelit ekzistues të të ardhurave të punëtorëve në sektorin real
- Pjesë përbërëse e ekipeve që punojnë në propozimin e këtyre masave duhet të jenë sindikatat nga sektori real, veçanërisht sindikatat nga sektori më i prekur nga pasojat ekonomike të pandemisë
- T'i kushtohet vëmendje punëtorëve me kontrata me afat të caktuar. Përmes masave të qeverive në luftë me pasojat ekonomike është e domosdoshme të stimulohen dhe të mbështeten financiarisht punëdhënësit për të zgjatur këto kontrata

Për Serbinë prioritet janë:

- Nisja e dialogut social me pjesëmarrjen e të gjithë akterëve politikë dhe partnerëve socialë me qëllim të arritjes së një konsensusi kombëtar për një pako masash për luftën kundër pasojave socio-ekonomike të epidemisë COVID-19
- Kryerja e analizave të efekteve të masave të miratuara gjatë gjendjes së jashtëzakonshme në shoqëri dhe ruajtja e nivelit më të lartë të të drejtave ekonomike dhe sociale gjatë periudhës së rimëkëmbjes, me theks të veçantë në respektimin e të drejtave të kategorive më të rrezikuara të punëtorëve, siç janë punëtorët në ekonominë joformale dhe në punësimet e pasigurta, punëtorët më të moshuar dhe ata me detyra familjare
- Demonstrimi i përkushtimit thelbësor ndaj standardeve të punës së dinjitetshme dhe integrimeve evropiane në fushën e punësimit dhe politikës sociale me miratimin e rregulloreve dhe strategjive të bazuara në konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe direktivat e Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian
- Nisja e reformës së legjislacionit të punës në drejtim të avancimit të kushteve të punës dhe respektimit të të drejtës për kompensim të drejtë për të gjithë punëtorët, duke përfshirë heqjen e dualizmit mes punës në marrëdhënie pune dhe punës jashtë marrëdhënies së punës dhe përcaktimin e standardeve të: punës në distancë, formave atipike të punës (të tilla siç është puna përmes platformave) dhe punës me pagesë të pamjaftueshme (siç është ofrimi i kujdesit)
- Forcimi urgjent i shërbimeve të inspektimit në fushën e shëndetësisë, punës dhe mbrojtjes sociale, ndër të tjera, përmes: punësimit të inspektorëve të rinj, prokurimit të pajisjeve dhe rritjen e transparencës së punës së institucioneve
- Vënia e tatimeve shtesë atyre që në kushtet e pandemisë fituan ekstra profit nga tregtimi me pajisje mbrojtëse
- Mundësimi i trajtimit të barabartë të punëtorëve në sektorin shtetëror dhe privat sa i përket të drejtave për ndërprerje të punës shkaku i pandemisë

Për Maqedoninë e Veriut prioritet janë:

- Fuqizimi i dialogut social, jo vetëm në mënyrë deklarative, por edhe në thelb, si dhe të pranohen kërkesat e organizatave dhe sindikatave që punojnë për avancimin e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat
- Forcimi i kapaciteteve të Inspektoratit Shtetëror të Punës, pasi që në numrin më të madh të ndërmarrjeve nuk ka organizata sindikale, dhe Inspektorati është i vetmi që mund të ndihmojë në situatat kur shkelen të drejtat e punonjësve
- Bashkëpunim më i madh ndërmjet të gjitha institucioneve, të tilla si Agjencia e Punës dhe Punësimit, Drejtoria e të Ardhurave Publike dhe Inspektorati i Punës dhe Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, me qëllim të komunikimit të rregullt ndërmjet njësive rajonale që të zvogëlohet keqpërdorimi rreth pagesave të të ardhurave, ndërprerjeve të paligjshme të kontratave të punës, zvogëlimin e paligjshëm të orarit të punës, edhe pse punonjësit punojnë pa orar të shkurtuar të punës
- Kontroll më i madh i ndërmarrjeve që përfitojnë të holla të shtetit për të zvogëluar dëmin dhe përmirësuar likuiditetin gjatë kësaj krize socio-ekonomike, në kuptimin që këto firma gjithashtu duhet të paguajnë pagat për punonjësit, të respektojnë të drejtat e punëtorëve dhe shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës
- Të gjithë punonjësve që gjatë krizës kanë humbur vendin e punës t'iu mundësohet ndihmë shtetërore derisa të gjejnë një punë tjetër, pa marrë parasysh llojin e shkarkimit nga puna (duke pasur parasysh se ka pasur edhe shkarkime dhe ndërprerje të paligjshme të kontratave të punës, shkarkime shkaku i shkeljeve të rendit dhe disiplinës, etj.)

Prioritetet për Kosovën do të jenë:

- Zhvillimi dhe zbatimi i kontratës kolektive të përgjithshme dhe kontratave sektoriale me qëllim të avancimit dhe mbrojtjes se të drejtave të punëtorëve duke marrë parasysh çdo kontribut të tyrë në vendin e punës, sektor dhe në ekonomi;
- Të zhvillohet strategjia nacionale për sigurinë dhe shëndetin në punë duke bazuar në rekomandimet nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) dhe Agjencia Europiane për Siguri dhe Shëndet në punë.
- Qeveria të fuqizojë kapacitetet e Inspektorateve të punës dhe atyre sektorial dhe të hartojë legjislacion të ri për siguri dhe shëndet në punë për sektorin e policisë, ushtrisë dhe zjarrefikësve.
- Ndihmë e vazhdueshme pas tejkalimit të fazës emergjente për bizneset e vogla dhe të vetë-punësuarit me vështirësi ekonomike të shkaktuara nga pasiviteti ekonomik në kohë të pandemisë;
- Fuqizimi i dialogut social të të gjithë sindikatave dhe organizatat e specializuara në të drejtat e punës bashkë me qeverinë në mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet të ndryshme të shëndetit dhe sigurisë në punë;
- Hartimi dhe zbatimi i masave konkrete për përfitime nga pakoja e rimëkëmbjes financiare duke përfshirë të gjitha sektoret e punës pa dallime dhe në dialog të vazhdueshëm më sindikatat dhe organizatat relevante;
- Të prioritizohet ri-shqyrtimi dhe aprovimi ne Kuvend i reformes per pakon e legjislacionit te punes, duke rikthyer dispozitat e ligjit për leje të lindjes dhe prindërore në kuadër të ligjit të punës;
- Koordinim të shtuar mes partnerëve social për themelimin dhe fuqizimin e sindikatave të reja në sektorin privat dhe mbështetjen e federatave dhe sindikatave ekzistuese;
- Formalizim i metutjeshëm i ekonomisë duke rritur numrin e punëtorëve formal përmes masave ekonomike për stimulim të formalitetit.
- Të funksionalizohet ligji për sigurim shëndetësor dhe të themelohet fondi për sigurime shoqërore në nivel kombëtar për të gjitha sektoret e ekonomisë.

Shëndeti publik është interesi më i rëndësishëm i të gjithë njerëzve në Ballkanin Perëndimor. Në të gjitha vendet, është e domosdoshme të kërkohet miratimi i rregulloreve me të cilat do të obligohen shtetet që për rastet e pandemisë të posedojnë pajisje mbrojtëse dhe barëra të cilat mund të përdoren vetëm atëherë.

Nënshkruesit e Deklaratës

Me këtë deklaratë dëshirojmë t'ua tërheqim vëmendjen qeverive tona si dhe publikut. Barrën e krizës nuk duhet ta përballojnë vetëm punëtorët. Kjo është arsyeja pse të gjithë ne nënshkruesit e kësaj Deklarate më poshtë po luftojmë për ruajtjen e të drejtave të punës dhe punës së dinjitetshme.

Nënshkruesit: